



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E TIRANËS

Drejtuar: Bashkimit të operatorëve ekonomik “5D Konstruksion” shpk & “BAMI” shpk

Adresa: Rruga "Andon Zako Çajupi", Qendra Zayed Bussiness Center, seksioni 3 C, D, kati III-të ,Tiranë.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Rehabilitim i qendrës Kinostudio”.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Rehabilitim i qendrës Kinostudio”.

2. Numri i referencës së procedurës/lotit: REF- 43728-09-28-2022

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Fondi limit: 583,046,084 (pesëqind e tetëdhjetë e tre milion e dyzetë e gjashtë mijë e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: me të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2022 miratuar me VKB Nr. 166, datë 24.12.2021 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2022”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarik duke nisur nga data e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 17.10.2022, ora 10:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 135 datë 03.10.2022.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Bashkimi i operatorëve ekonomik “5D Kontruksion” shpk & “BAMI” shpk
NUIS L61322023P & NUIS J94416206R**

Vlera e ofertës = **345,099,918** (treqind e dyzetë e pesë milion e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

**2. Bashkimi i operatorëve ekonomik “ALBAVIA” shpk & “EUROVIA” shpk
NUIS J81527001Q & NUIS L91426009G**

Vlera e ofertës: **412,377,014.61** (katërqind e dymbëdhjetë milion e treqind e shtatëdhjetë e shtate mijë e katërmëdhjetë pike gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

**3. Bashkimi i operatorëve ekonomik “CURRI” shpk & “BE - IS” shpk
NUIS J67902718S & NUIS K71412003A**

Vlera e ofertës = **429,950,301** (katërqind e njëzetë e nëntë milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë e treqind e një) lekë pa TVSH.

**4. Bashkimi i operatorëve ekonomik “SIRETA 2F” shpk & “EURO-ALB” shpk
NUIS K51501008J & NUIS K66613407H**

Vlera e ofertës = **444,333,222** (katërqind e dyzetë e katër milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind njëzetë e dy) lekë pa TVSH.

**5. Bashkimi i operatorëve ekonomik “STERKAJ” shpk & “NDREGJONI” shpk
NUIS J68310708M & NUIS K31329048I**

Vlera e ofertës = **447,304,730.01** (katërqind e dyzetë e shtatë milion e treqind e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë pike zero një) lekë pa TVSH.

**6. Bashkimi i operatorëve ekonomik “FUSHA” shpk & “SHANSI INVEST” shpk
NUIS J61922018S & NUIS J61924002T**

Vlera e ofertës = **452,411,111.16** (katërqind e pesëdhjetë e dy milion e katërqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë pike gjashtëmbëdhjet) lekë pa TVSH.

**7. Bashkimi i operatorëve ekonomik “AGRI CONSTRUCTION” shpk & “ULZA”
shpk
NUIS K01725001F & NUIS J67902928O**

Vlera e ofertës = **456,299,188.075** (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë pike zero shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

8. Bashkimi i operatorëve ekonomik “Shendelli” shpk & “B93 II” shpk & “METEO” shpk & “B-93” shpk NUIS K07924803N & NUIS L52209050O & NUIS L26310801C & NUIS J62903508R

Vlera e ofertës = **459,785,056** (katërqind e pesëdhjete e nënte milion e shtatëqind e tetëdhjete e pesë milion e pesëdhjete e gjashte) lekë pa TVSH.

9. Operatori ekonomik “GJIKURIA” shpk NUIS J62903456H

Vlera e ofertës = **478,024,398.23** (katërqind e shtatëdhjetë e tetë milion e njëzetë e katër mijë e treqind e nentëdhjete e tetë pike njëzetë e tre) lekë pa TVSH.

10. Bashkimi i operatorëve ekonomik “Ante-Group” shpk & “NDERTIM MONTIMI PATOS” shpk & “NOVA Construction 2012” shpk NUIS J62904100D & NUIS J63229454K & NUIS L22404012D

Vlera e ofertës = **495,460,506.54** (katërqind e nëntëdhjete e pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e gjashte pike pesëdhjete e katër) lekë pa TVSH.

11. Bashkimi i operatorëve ekonomik “DAJTI PARK 2007” shpk & “Pastrime Silvio” shpk & “DENIS-05” shpk

NUIS K11507003S & NUIS K91413010N & NUIS K51518029B

Vlera e ofertës = **495,880,370.59** (katërqind nentëdhjetë e pesë milion e tetëqind e tetëdhjete mijë e treqind e shtatëdhjete pike pesëdhjete e nentë) lekë pa TVSH.

12. Operatori ekonomik “ALB – STAR” shpk NUIS J62903512W

Vlera e ofertës = **553,830,782.16** (pesëqind e pesëdhjetë e tre milion e tetëqind e tridhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjete e dy pike gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm përkatësisht për arsyt e mëposhtme:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomik “ALBAVIA” shpk & “EUROVIA” shpk

Bashkimi i operatorëve ekonomik “Albavia” shpk & “Eurovia” shpk nuk përmbush piken 1, germa a), Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, dokumentat standarte të tenderit ku percaktohet: Ofertuesi duhet të paraqesë: *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1; ...Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë*”. Pas verifikimi çmimeve të ofertuara në preventivin e punimeve të dorezuar në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se ka gabime në mbledhjen e të zerave të preventivit pasi nuk është mbledhur në shumën totale, vlera prej **40,371,000, vlerë e cila i pergjigjet zërit A-1 punime prishje edhe çmontim.** Në

Adresa: Sheshi “Skënderbej”, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

dokumentet standarte te tenderit “Udhezime per kandidatet”, pika 22, “Vlerësimi i ofertave dhe korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta”, parashikohet se: “Nëse ka ndonjë mospërputhje në çmimin total, kur totali është shuma ose diferenca e nën-totaleve, çmimi nën-total mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet bazuar në të. Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar; ”. Per rrjedhoje duke qene se vlera e gabimit ne preventivin e punimeve eshte me e madhe se 2%, oferta refuzohet.

Sa me siper pas shqyrtimit te dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimeve, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e Bashkimit të operatorëve ekonomik “Albavia” shpk & “Eurovia” shpk, nuk është në përputhje me kërkesat e Dokumenteve Standarte të Tenderit, për rrjedhojë **nuk kualifikohet.**

2. Bashkimi i operatorëve ekonomik “SIRETA 2F” shpk & “EURO-ALB” shpk

Operatori ekonomik Euro-Alb nuk përmbush pikën 10, Kapaciteti teknik, kriteret e veçanta te kualifikimit, dokumentave standarte te tenderit ku citohet: “Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës specialist “Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim” në përputhje me Ligjin Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin”, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate leshuar nga Drejtoria MZSH (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës “Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim”). Nga verifikimi i dokumentacionit te dorezuar ne sistemin elektronik te prokurimit rezulton se operatori ekonomik ne formularin përmbledhës se vetedeklarimit, pjesa III/b Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate, operatori ekonomik nuk ka deklaruar 1 (një) punonjës specialist “Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpëtim e cila bie ne kundërshtim me kërkesat e kërkuara nga dokumentat standarte te tenderit.

Operatori ekonomik Sireta 2F Shpk, nuk ploteson piken 15, te Kapacitetit teknik, ne Kriteret e Veçanta te Kualifikimit, te dokumentave standarte te tenderit ku percaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e menaxhimit te energjise ISO 50001-2011 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”. pasi nga verifikimi i dokumentacionit te dorezuar ne sistemin elektronik te prokurimit rezulton se operatori ekonomik Sireta 2F Shpk, nuk ka paraqitur certifikaten ISO 50001:2011 sipas zerave te punes qe ka marre persiper ne baze te marreveshjes se bashkepunimit.

Sa me siper pas shqyrtimit te dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimeve, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e Bashkimit të operatorëve ekonomik “SIRETA 2F” shpk & “EURO-ALB” shpk, nuk është në përputhje me kërkesat e Dokumenteve Standarte të Tenderit, për rrjedhojë **nuk kualifikohet.**

3. Bashkimi i operatorëve ekonomik “FUSHA” shpk & “SHANSI INVEST” shpk

Operatori ekonomik Shansi Invest shpk nuk përmbush piken 9, Kapaciteti teknik, Kriteret e veçanta te Kualifikimit, te dokumentave standarte te tenderit ku citohet: *Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme,*

Diplome/certificate e leshuar nga autoritetet te akredituara pergjegjese shteterore ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, te akredituar nga DPA, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë"). Ne formularin permbledhës se vetedeklarimit pjesa III/b operatori ekonomik Shansi Invest shpk nuk ka deklaruar 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" cka bie ne kundërshtim me kriteret e kërkuara ne dokumentat standarte te tenderit.

Operatori ekonomik Shansi Invest shpk nuk permbush piken 10, Kapaciteti teknik, Kriteret e veçanta te Kualifikimit, te dokumentave standarte te tenderit ku citohet: *Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës specialist "Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim" në përputhje me Ligjin Nr. 152/2015 "Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate leshuar nga Drejtoria MZSH (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim").* Ne formularin permbledhës se vetedeklarimit pjesa III/b operatori ekonomik Shansi Invest shpk nuk ka deklaruar 1 (një) punonjës specialist "Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim" e cila bie ne kundërshtim me kriteret e kërkuara ne dokumentat standarte te tenderit.

Sa me siper pas shqyrtimit te dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimeve, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e Bashkimit të operatorëve ekonomik **"FUSHA" shpk & "SHANSI INVEST" shpk**, nuk është në përputhje me kërkesat e Dokumenteve Standarte të Tenderit, për rrjedhojë **nuk kualifikohet.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **bashkimi i operatorëve ekonomik "5D Konstruksion" shpk & "BAMI" shpk**, me adresë: : Rruga "Andon Zako Çajupi", Qendra Zayed Bussiness Center, seksioni 3 C, D, kati III-të ,Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **345,099,918** (treqind e dyzetë e pesë milion e nëntedhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëmbdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në Nenin 109 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".